Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/183 Nr. i faq/Br.str/No.pg 2
Data/Datum/Date 29 / 03 / 2021

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.03.2021 merr këtë:

V E N D I M
Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 01/217/21, i datës 19.03.2021 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën **1** të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Zoqisht, në vendin e quajtur Pregan / Babushina, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510032-00227-1 në emër të Komunës së Rahovecit, me kulturë mal i klasës 2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 12527m^2 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e shtatë metra katror) dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 2500m^2 (dymijë e pesëqind metra katror).

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen.

3. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej (10) vite.

4. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshojë kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës: 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvillojnë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.

9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

10. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në web-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.183/21
Me datë: 29.03.2021

REPUBLIKA E KOSOVA - KUVENDI I KOMUNËS / REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPAL ASSEMBLY - RAHOVEC / ORAHOVAC

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit